



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:017424  
Datë: 22.01.2024  
Numri i dokumentit: 05218822

**PA1.nr. 925/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të akuzuarit R.M., nga Peja, për shkak të veprës penale Ndërtimi pa leje nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesave të mbrojtësve së të akuzuarit, të ushtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr. 120/2021 të datës 19.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 11 Janar 2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohen si të pabazuara** ankesat e mbrojtësve së të akuzuarit R.M., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr. 120/2021 të datës 19.04.2023, **VËRTETOHET.**

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr. 120/2021 të datës 19.04.2023, i akuzuari R.M., është shpallur fajtor për shkak të veprës Ndërtimi pa leje nga neni 359 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve me kusht se ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 4 (katër) viteve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen tjetër vepër penale.

Është urdhëruar rrënimi i objektit të ndërtuar pa leje i përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës se shkalles se pare.

I akuzuari është obliguar që të paguaje shpenzimet e procedurës penale të cilat dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20 ( njëzet ) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 20 ( njëzet ) euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :**

Mbrojtësi i të akuzuarit R.M. – av. Gëzim Kollçaku nga Peja, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare të anulohet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje apo që i njëjti të ndryshohet dhe i akuzuari në mungesë të provave të lirohet nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.M. – av. Jakup Çeku nga Peja, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare të anulohet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje apo që i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit t’i shqiptohet dënimi dukshëm më i ulët se sa dënimi i shqiptuar nga ana gjykatës se shkalles se pare.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shqaruar përkitazi me ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit R.M., me shkresën e vet PPA.II.nr. 962/23 të datës 02.08.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesat e mbrojtësve të të akuzuarit t’i refuzojë si të pabazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës se shkalles se pare të vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-se, në të cilën prezantuan i akuzuari R.M., si dhe mbrojtësi i tij av.Gëzim Kollçaku nga Peja, ndërsa palët e tjera munguan, andaj seanca e kolegjit u mbajt në pajtim me nenin 390 paragrafi 4 të KPPRK-se. Mbrojtësi i të akuzuarit në tërësi mbeti pranë ankesës së ushtruar me shkrim dhe pas elaborimit të së njëjtës propozoi që ankesa të aprovohet si e bazuar. I akuzuari në tërësi përkrahu fjalët e mbrojtësit se tij.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësve të të akuzuarit R.M., dhe gjeti se :

#### **- Ankesat nuk janë të bazuara.**

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtësi i të akuzuarit R.M., av.Gëzim Kollçaku, me ankesë pretendon se aktgjykimi shkalles se pare është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase gjykata e shkalles se pare me rastin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri nuk i ka vlerësuar në mënyrë të duhur se a janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 242 pika 3 të KPPRK-së lidhur me pranimin e fajësisë, ngase pranimi i fajësisë nga i pandehuri nuk e vërteton çdo element të veprës penale dhe se i njëjti është nxjerr vetëm në bazë të deklaratimit mbi pranimin e fajësisë pa prova të tjera që e mbështesin pranimin e fajësisë dhe se në rastin konkret ngase nuk ka pasur prova tjera gjykata ka qene e obliguar që ta refuzojë pranimin e fajësisë ngase

ne vendin ku eshte ndërtuar objekti ne këtë zonë parashihet që mund të bëhet edhe ndërtim edhe rindërtim por duhet te jetë në harmoni me ligjet përkatëse dhe me Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar e që i njëjti ende nuk eshte aprovuar nga Kuvendi i Rep.së Kosovës.

Sipas mbrojtësit së të akuzuarit, gjykata e shkalles se pare ka zbatuar dispozitat e ligjit per ndërtim e që ligji per ndërtim nuk mund te zbatohet ne rastin konkret ngase së pari duhet te aprovohet Plani Hapësinor per Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, kur ne te njëjtin do te parashihet vendet se ku mund te merret leja, pra gjykata e shkalles se pare ne rastin konkret nuk eshte dashur qe te aprovoj pranimin e fajësisë. Gjithashtu pretendon se aktgjykimi nuk eshte përpiluar ne përputhje me nenin 369 pika 7 dhe 8 te KPPRK-se, me arsyetim se dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënës mes veti dhe me arsyet e paraqitura ne arsyetimin e aktgjykimit dhe me shkresat e lendes. Pretendon se dispozitivi i aktgjykimit është kundërthënës dhe i pakuptueshëm me brendinë e tij dhe arsyet e aktgjykimit, e të cilat shkelje aktgjykimin e shkalles se pare e bëjnë te paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore te mbrojtësit së të akuzuarit lidhur me shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare është i qarte dhe i kuptueshëm dhe si i tille përmban arsye te mjaftueshme përkitazi me faktet relevante te kësaj çështje juridiko penale si dhe faktet nga te cilat varet edhe aplikimi i drejte i dispozitave te ligjit penal. Theksimet e lartpërmendura ne ankese nuk janë te natyrës se tille për te konstatuar se aktgjykimi përmban mangësi te atilla procedurale qe do ta bënin te paqëndrueshëm ligjshmërinë e tij. Gjykata e shkalles se pare ne mënyre te drejte dhe te plote i ka vërtetuar te gjitha faktet vendimtare te kësaj çështje dhe se është mbështetur ne pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit të bërë ne shqyrtimin fillestar te datës 19.04.2023 i cili pranim eshte bërë pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij – av. Jakup Çeku si dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës si procesverbali mbi kontrollin e kryer me numër 000196 i datës 30.11.2020, foto dokumentacioni nga shkresat e lendes si dhe raporti i policit hetues i datës 05.12.2020, andaj Gjykata e Apelit pretendimet ankimore të mbrojtësit së të akuzuarit i refuzoi si te pabazuara.

Gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar të datës 19.04.2023 në bazë të nenit 242 të KPRK-së ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës si procesverbali mbi kontrollin e kryer me numër 000196 i datës 30.11.2020, foto dokumentacioni nga shkresat e lendes si dhe raporti i policit hetues i datës 05.12.2020. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal, andaj edhe pretendimet ankimore te mbrojtësit se te akuzuarit ne lidhje me shkeljen e ligjit penal ne dëm të të akuzuarit i refuzoi si te pabazuara.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtësi i të akuzuarit R.M., av.Gëzim, Kollçaku, me ankesë pretendon se si pasojë e shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale është nxjerr edhe vendimi mbi sanksionin penal dhe se gjykata e shkalles se pare nuk është dashur qe ta aprovoj pranimin e fajësisë dhe të njëjtin ta liroj nga akuza ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit R.M., av.Jakup Çeku, sa i përket sanksionit penal propozon që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës se shkalles se pare dhe të akuzuarit t’i shqiptoj dukshëm me te ulet apo qe te njëjtin ta anuloj dhe çështjen ta kthej ne rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit konstatoi se gjykata e shkalles se pare me rastin e vendosjes lidhur me sanksionin penal i ka vlerësuar te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-së e te cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj i refuzoi si të pabazuara ankesat e mbrojtësve se te akuzuarit edhe lidhur me këtë bazë ankimore duke vërtetuar aktgjykimin e ankimuar te gjykatës se shkalles se pare e me bindje se me dënimin e shqiptuar nga ana e Gjykatës se shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tij, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.925/23 më 11.01.2024**

**Procesmbajtës**  
**Arben Arifi**

---

**Anëtarët e kolegjit**  
**Abdullah Ahmeti**

---

**Kryetar i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

---

**Zyhdi Haziri**

---